



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 14.08.2026

MBLEDHJA Nr. 36,
Datë 18.08.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 18.08.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 36 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e "Rregullave për regjistrimin pranë ERE-së të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike”.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Bushtica 2017” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k rinovimin e licencës veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE, për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të HEC Arcovë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 44, datë 11.02.2026, dhënë në lidhje me ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI